

## KONTRATE PER SHITJE KUOTASH



Kjo kontrate per shitjen e kuotave te shoqerise COMEC Sh.p.k, qe me poshte do te quhet Kontrate lidhet sot me date 12.04.1997 , nepermjet paleve : . . . . .

Z. Giuseppe MORELLI, i biri i Guilielmos, lindur me 1948 ne Campotione C.SO G. Marconi 2 ( Itali ) shtetas italian, me nr passaporte 013096, zoterues i 1/3 te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise te barabarta me 1.000 ( njemije ) USD, ne shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar COMEC, me cilesine e Shitesit ;

Pirro GJINARI i biri i Jorgjit dhe i Aliqit, datelindja 1957, lindur ne Tirane dhe banues po ne Tirane ,rruga M.Tutulani pall13/1,shk1,ap1 ortak shqiptar i kesaj shoqerie dhe zoterues i 1/3 te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise te barabarta me 1.000 ( nje mije ) USD, me cilesine e Bleresit ;

Stojan ANGJELI i biri i Margaritit dhe i Drites, datelindja 1957, lindur dhe banues ne Tirane rruga M. Gjollësha, pall 43,shk2, ap163, ortak shqiptar i kesaj shoqerie dhe zoterues i 1/3 te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise te barabarta me 1.000 ( nje mije ) USD, me cilesine e Bleresit ;

Palet nepermjet kesaj kontrate kerkojne te ndryshojne raportet e pjesemarrjes ne kapitalin themeltar te shoqerise COMEC , nepermjet blerjes nga ana e ortakeve shqiptar te kuotave te kapitalit te ortakut italian Giuseppe MORELLI .

Kuotat qe zoti Giuseppe MORELLI do ti shese zoterinjve Pirro GJINARI dhe Stojan ANGJELI, jane 1/3 e kuotave te kapitalit themeltar, dhe jane vleresuar ne vleren e tyre nominale 1.000 USD ( njemije ).

Sasia prej 1.000 ( njemije ) USD i eshte paguar zotit Giuseppe MORELLI perpara momentit te nenshkrimit te kesaj kontrate, perkatesisht 500 USD ( peseqind ) nga zoti Pirro GJINARI dhe 500 USD ( peseqind ) nga zoti Stojan ANGJELI.

Palet rane dakort qe nga momenti qe do te noterizohet kjo kontrate zoti Giuseppe MORELLI zhvishet nga cdo e drejte dhe kompetence mbi shoqerine, si dhe zoti Pirro GJINARI behet zoterues i 1/2 te kapitalit themeltar, kurse zoti Stojan ANGJELI behet zoterues i gjysmes tjeter te kapitalit themeltar te shoqerise COMEC Sh.p.k. Konkretisht te dy ortakët zoterojne nga pesedhjetë kuota secili ku nje kuote ka vleren tridhjet USD.

Kontrata u perpilua ne kater kopje te njejta, u lexua me ze dhe u gjet sipas vullnetit te lire e te plote, dhe u nenshkrua rregullisht sipas ligjit.

SHITESI  
Giuseppe MORELLI

BLERESI  
Pirro GJINARI

BLERES  
Stojan ANGJELI